

REPUBLIKA E KOSOVËS

MINISTRIA E ZHVILLIMIT EKONOMIK (MZHE)

KËRKESË PËR SHPREHJE TË INTERESIT (SHËRBIME KONSULENTE – KONSULENT INDIVIDUAL)

Vendi: Kosova
Emri i projektit: Projekti për Eficiencë të Energjisë dhe Energji të Ripërtëritshme (PEEERK)
Specialist financiar
Nr. i kredisë: 55080-XK
Titulli i detyrës: Specialist financiar
Nr. i referencës: PEEERK/3.4/2015/4

Ministria e Zhvillimit Ekonomik ka aplikuar për financim nga Banka Botërore Projektin për Eficiencë të Energjisë dhe Energji të Ripërtëritshme në Kosovë (PEEERK), dhe synon të përdorë një pjesë të të ardhurave për shërbime të konsulencës.

Në kuadër të shërbimeve të konsulencës (“Shërbimet”), konsulenti individual kërkohet që të ndihmojë Agjencinë e Kosovës për Eficiencë të Energjisë (AKEE) dhe Njësinë e Zbatimit të Projektit (NJZP) në kryerjen e përgjegjësisë të menaxhimit financiar në përputhje me dispozitat e parashikuara në Marrëveshjen e Financimit të nënshkruar në mes të Republikës së Kosovës dhe Shoqatës Ndërkombëtare për Zhvillim (Banka Botërore) dhe procedurat e përshkruara në Manualin e Operimit (MO).

Detyra pritët të zgjasë nga qershori 2015 deri në qershor 2016, me angazhim me gjysmë orari, në bazë të performancës adekuate.

Agjencia për Eficiencë të Energjisë në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik fton individët (“Konsulentët”) e kualifikuar që të shprehin interesin e tyre në ofrimin e Shërbimeve. Konsulentët e interesuar duhet të dorëzojnë CV-të e tyre, bashkë me dëshmitë përkatëse të cilat dëshmojnë se i zotërojnë kualifikimet e kërkuara dhe përvojën relevante për t’i realizuar shërbimet.

Kriteret për pranueshmëri janë: Shkollim universitar/i lartë në ekonomi e financa; së paku 5 vite përvojë në financa dhe menaxhim financiar; përvoja me organizata ndërkombëtare dhe projekte të Bankës Botërore është përparësi; të ketë njohuri të mira dhe të dëshmuara të kontabilitetit të Qeverisë, sistemeve të menaxhimit financiar dhe sistemit të buxhetimit, si dhe kërkesave tatimore dhe ligjore në Kosovë; të ketë njohuri të mira të politikave financiare dhe të kontabilitetit, rregullave dhe rregulloreve që kanë të bëjnë me organizatat ndërkombëtare, preferohet lidhur me Bankën Botërore; përvojë e mëparshme me sistemin e Thesarit *Free Balance*; komunikim të shkëlqyer dhe aftësi ndërpersonale me rrjedhshmëri në gjuhën shqipe dhe angleze, të jetë person i motivuar, me fokus në rezultate dhe i cili është në gjendje të punojë si pjesë e një ekipi.

Konsulentëve të interesuar t’i kushtojnë vëmendje paragrafit 1.9 të Udhëzimeve të Bankës Botërore: *Përzgjedhja dhe punësimi i Konsulentëve (në kuadër të Kredive IBRD dhe Kredive dhe Granteve IDA) nga Huamarrësit e Bankës Botërore* të datës janar 2011 (“Udhëzimet e Konsulentit”), që përcaktojnë politikën e Bankës Botërore për konfliktin e interesit.

Konsulenti do të përzgjidhet në përputhje me nenin V, Përzgjedhja e Konsulentëve Individualë, të Udhëzimeve për Konsulentët.

Më shumë informata mund të merrni në adresën në vijim, gjatë orarit të punës – 09.00 deri 16.00 h.

Shprehja e interesit (CV dhe dokumentet e shoqëruara) duhet të dorëzohen në kopje të shtypura në adresën në vijim (personalisht apo përmes postës) deri më **8 qershor 2015, në ora 14.00**.

Qeveria e Republikës së Kosovës
Ministria e Zhvillimit Ekonomik (MZHE)
Projekti për Eficiencë të Energjisë dhe Energji të Ripërtërithme në Kosovë (PEEERK)
Zyra nr. 107 (kati I)
Rruga Nëna Terezë nr. 36
10000 Prishtinë – Kosovë
Për:
Z. Selami Berisha
Drejtor i Prokurimit – MZHE
Tel: +38 1 38 200 21 532
E-mail: selami.berisha@rks-gov.net
dhe
Z. Luan Asllani
Specialist i Prokurimit - PEEERK
Tel: +381 38 200 21 563
E-mail: Luan.Asllani@rks-gov.net